Aktiv

Raporti nga rezultati i hulumtimeve



# Analiza e trendit:
## Qëndrimet e qytetarëve në Kosovën veriore

Mitrovicë veriore

## Organizata mbikqyrëse

OJQAKTIV

## Autorët e hulumtimit

MA Nikola Jović

Milica Andrić

Sara Ostojić

OJQAKTIV

Kralja Petra I, 183a, Mitrovica veriore

email: office@ngoaktiv.org

www.ngoaktiv.org

Mitrovicë veriore

Qershor 2016.

# Përmbajtja


- Metodologjia hulumtuese……………………………………….4
- Rezultatet kyçe…………………………………………………..……5
- Përshkrimi i modelit……………………………………………..6-8
- Rezultatet e hulumtimeve……………………………………9-39
- Përfundimi ……………..………………………………..……..40-41

# Metodologjia hulumtuese

**Metoda hulumtuese**:  Analizë hulumtuese e drejtpërdrejt **(***F2F*)

**Analiza:** 50 pyetje që zgjasin  15 min.

**Periudha e hulumtimit: 4**Maj  – 11 Maj 2016

**Vendi/et e hulumtimit**Mitrovicë veriore, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan

**Masa e modelit:** 909 të anketuar

**Lloji i modelit:**Shembuj nga shtresat e rastësishme – shtresimi i bazuar ne komunën banuese.

**Gabim statistikor:** 9 5% intervali konfidencial statistikor për margjinat e gabimit prej50% duke llogaritur +/-3.2

**Shtresimi i pozitës:**  Gjinia, mosha, vendbanimi dhe shkalla e arsimimit

## Rezultatet kyçe

5.6%e anketuarve vleresojnë situaten politike ne Kosovë si të mirë.

_______________________

Tre nga katër të anketuarit konsiderojnë se gjërat në Kosovë shkojnë në drejtim të gabuar.

_______________________

Më tepër se 60% e të anketuarve konsiderojnë se në Kosovë nuk ka politikan që mund tu besohet.

_______________________

75% e të anketuarve besojnë se Rusia  duhet të jetë partneri i tyre më i madh kur bëhet fjalë për lobimin e serbëve nga Kosova.

_______________________

Çdo ipesti ianketuar është në favor të Marrëveshjes së Brukselti gjersa 40% nuk u deklaruan fare.

_______________________

22.7% e të anketuarvepërkrahin pjesëmarrjen e serbëve në institucionet e Kosovës.

_______________________

Më shumë se 35% e të anketuarve deklarohen se do të votojnë në zgjedhjet e ardhshme të Kosovës.

_______________________

Çdo i dyti i anketuar deklaron se nuk ndiheti lirë të shprehë qëndrimin e vet politik.

_______________________

Të anketuarit deklarohen se krimi i organizuar, incidentet ndër etnikedhe jo stabiliteti politik konsiderohen si rreziku mëi madh i sigurisë.

_______________________

8.4% e të anketuarve besojnë se Marrëveshja e Brukselti avancon liritë dhe të drejtat e serbëve që jetojnë në  Kosovë.

_______________________

Çdo i pesti i anketuar shprehet se nuk e sheh veten në Kosovë në pesë vitet e ardhshme.

_______________________

Më tepër se  80% e të anketuarve besojnë se Bahkimi Evropian anon më tepër kah Prishtina në procesin negocues mes Prishtinës dhe Beogradit.

.

_______________________

14.4% e të anketuarve përkrahë anëtarësimin e Kosovës në BE

# Përshkrimi i modelit

- **Të dhënat sipas gjinisë:**




- **Mosha**

Mosha mesatare e të anketuarve ishte 49 vj.

Të dhënat sipas moshës:



## Shkalla e arsimimit




## Statusi i punësimit



## Vendbanimi



35
30
25
20
15
10
5
0
30.8
29.6
24.1
15.5
Mitrovica veriore
Zveqani
Leposaviq
Zubin Potok

# Rezultatet e hulumtimit

1. **Vlera prej 1 deri 5, 1 vlerësohet si "shumë keq" dhe 5 vlerësohet si "shumë mirë", si do të vlerësonit ju:**

| | Rezultati mesatar |
|---|---|
| Situata politike në Kosovë | 1.9 |
| Situate e sigurisë në Kosovë | 2 |
| Situate ekonomike në Kosovë | 1.9 |
| Situata e juaj materiale | 2.5 |




Të anketuarit, pa marrë parasysh moshes, vleresojnë situaten politike të ngjashme, gjithashtu edhe situatën ekonomike dhe ate të sigurisë vlerësojnë në mënyrë të ngjashme pa ndonjë dallim të madh.

Ata të cilët u shprehën më të pakënaqur me situatën e tyre materiale ishin të anketuarit më të moshuar (mbi 66vj).Në këtë grupmoshë çdo idyti nga të anketuaritishtei pakënaqur me gjendjen e vet material. Ky numër bie tek të anketuarit më të rinjë.

Nëse kjo çështje vlerësohet sipas shkallës së arsimimit atëher shihet shkalla e pakënaqësisë lidhur me situatën politike rritet krahas shkallës së arsimimit të anketuarve.  E njejta gjë vlen edhe për situatën ekonomike dhe ate të sigurisë.

| | Pakënaqësitë me situatën politike |
|---|---|
| fillore | 58,5% |
| Të mesme | 71% |
| Teknike | 85,1% |
| Univerzitare | 82,5% |

Çdo i dyti i anketuar me arsim fillor ose të mesëm vlerësojnë situatën e tyre materiale sitë keqe, gjersa çdo i treti i anketuar me shkallë të lartë të arsimimit vlerësojnë situatën e tyre materiale negative.

E sa i përket vendbanimit ne mund të shohim se  23% e banorëve të Mitrovicës veriore janë të kënaqur me situatën e tyre materiale gjersa në Zveçan bie në 10.8% të të anketuarve.Banorët e të gjitha katër komunave në mënyrë të ngjashme vlerësojnë situatën politike, ekonomike dhe ate të sigurisë.

**2. Shikuar në përgjithësi, a po shkojnë gjërat në Kosovë në drejtim të duhur?**



Si përgjigje në këtë pyetje është se shihet një dallim i madh mestë anketuarve të grupmoshave të ndryshme.Përafërsisht 13% e të rinjëve mes moshës 18 dhe29vj.mendojnë se gjërat në Kosovë po zhvillohen në drejtim të duhur.  Përqindja e të anketuarve të cilët konsiderojnë se gjërat po ecin mirë në Kosovë rritet me moshën siprej moshës 30vj.- 45 19.7%, prej moshës 46vj.- 65 26% dhe këta mbi moshën 65 vj. 26% pohonin se gjërat në  Kosovë po shkojnë në drejtim të duhur.

Ekziston një korelacion lidhur me shkallën e arsimimit të anketuarve dhe përgjigjeve të tyre në këtë pyetje.Shihet se të anketuarit me Arsim më të lartë janë më skeptik për rrugën që ka marrë Kosova dhe nuk besojnë se gjërat po shkojnë në drejtim të duhur.

**3. Sipas mendimit tuaj,si do të jetë jeta e serbëve në Kosovë pas tri vitesh?:**




Vetem  8% e te anketuarve mes moshës 18 dhe 29 janë optimist se jeta e serbëve të  Kosovës do të përmirësohet në tri vitet e ardhshme.

## 4. Sipas mendimit tuaj, Cili është problemi më i madh në Kosovën veriore?




Varrësisht nga arsimimi, të anketuarit dallojnë në përceptimet e tyre lidhur me problemet kryesore në Kosovë.Banorët me arsimim fillor konsiderojnë situatën politike si problematike gjersa ata me arsimim më të avancuar prononcohen se problemi kryesor qëndron në situatën ekonomike.

## 5. A godasin problemet në Kosovë njejtë Serbët dhe Shqiptarët?



**6. A vizitoni shpesh vendet kur Shqiptarët janë shumic;?**




Më së shumti vendet me shumicë Shqiptare **vizitohen** nga te anketuarit më të moshuar. Ne gjithashtu mund të shohim një korrelacion me shkallën e arsimimit të anketuarve: ata me arsim fillor shkojnë më rrallë (1.7%) gjersa këta me arsimim univerzitar shkojnë më së shpeshti (21.3%.)

**7. Në përgjithësi, eksperienca e juaj me kontakte personale me Shqiptarët është:**



8. **Në vlerë prej 1 deri 5, me 1 si 'shumë keq' dhe 5 si 'shkëlqyeshëm', vlerësohet gjendja e marrëdhënieve ndër etnike mes komuniteteve të ndryshme në Kosovë:**

| | Vlerësimi mesatar |
|---|---|
| Serbët dhe Goranët | 3,8 |
| Serbëtdhe Boshnjakët | 3,1 |
| Serbët dhe Shqiptarët | 1,9 |




9. **A ka ndryshu situata ekonomike në Kosovë vitin e fundit?**



**10. Sa shpesh ipercjellni ndodhitë politike?**




**11. A ka ndonje politikan në Kosovë qe ti i beson?**




Të anketuarit me arsimim fillor më së tepërmi u besojnë politikanëve (27%), gjersa këta me arsimim universitar më pak (11.8%.)

Perpos kësaj , shkalla e besimit ndaj politikaneve dallon shume mes grupmoshave te reja dhe atyre te vjetra.

| | Unë i besoj politikanëve |
|---|---|
| 18-29 | 10% |
| 30-45 | 8,9% |
| 45-65 | 19,4% |
| 66 | 31,2% |

**12. Cilët janë politikanët Serbë në Kosovë që ju i besoni më së tepërmi?**



13. **Cilët janë politikanët Shqiptarë që ju u besoni më së shumti?**




14. **Në cilin shtet/institucion duhet te mbeshteten Serbët e Kosoves për politikë të jashtme dhe lobim?**



**15. A keni ndonjë dokument të lëshuar nga institucionet Kosovare?**




Ekziston nje dallim i madh mes gjeneratave te reja dhe atyre te vjetra kur behet fjale per dokumentet e insitucioneve Kosovare. Te anketuarit e vjeter kane dy here me teper gjase me pasë dokumente Kosovare se at ate rinjte.

**A shfrytëzoni shërbimet e ofruara nga institucionet Kosovare?**



## 16. Prej 1 deri 5, vlerëso kënaqësinë tuaj me institucionet vijuese:

| | |
|---|---|
| Qerveria e Serbisë | 3 |
| Zyra për Kosovën dhe Metohinë | 2.8 |
| Organet e përkohëshme të administrates lokale | 2.5 |
| Katër komunat e reja veriore te Kosovës | 2.4 |
| KFORi | 2.4 |
| Policia e Kosovës | 2.3 |
| UNMIK-u | 2.2 |
| Anëtarët serb të parlamentit kosovar | 2.1 |
| Ministrat serb në qeverinë e Kosovës. | 2 |
| Zyra e BE në Kosovë | 2 |
| EULEX-i | 1.9 |
| Qeveria e Kosovës | 1.7 |

## 17. Vlerëso prej 1 deri 5, besimin tuaj në institucionet vijuese:

| | |
|---|---|
| Qerveria e Serbisë | 3 |
| Zyra për Kosovën dhe Metohinë | 2.8 |
| Organet e përkohëshme të administrates lokale | 2.6 |
| Kater komunat e reja veriore te Kosovës | 2.5 |
| KFORi | 2.3 |
| Policia e Kosovës | 2.3 |
| UNMIK-u | 2.2 |
| Anëtarët serb të parlamentit kosovar | 2 |
| Ministrat serb në qeverinë e Kosovës. | 2 |
| Zyra e BE në Kosovë | 2 |
| EULEX-i | 1.8 |
| Qeveria e Kosovës | 1.7 |

**18. Çfarë është qëndrimi juaj ndaj Marrëveshjes së Brukselit?**




Këtu shihet një dallim i madh mes të anketuarve te moqëm dhe atyre të rinjë sai përket përkrahjes së Marrëveshjes së Brukselit.

| | Përkrahja per Marrëveshjen |
|---|---|
| 18-29 | 7.9% |
| 30-45 | 11.2% |
| 45-65 | 22.1% |
| 66 + | 33.3% |

Analizat gjithashtu tregojnë se ekziston një dallim mes mbështetësve të Marrëveshjes së Brukselit të ciët jetojnë në komuna të ndryshme.

| | Përkrahja për Marrëveshjen |
|---|---|
| Mitrovica Veriore | 13.2% |
| Zubin Potoku | 17% |
| Leposaviqi | 15.6% |
| Zveçani | 33,2% |

Kundërshtarët më të mëdhenj të Marrëveshjes së Brukselit janë të anketuarit me arsimim të lartë:

| | Unë nuk përkrahu marrëveshjen |
|---|---|
| Fillor | 26.2% |
| I mesëm | 35.4% |
| I lartë/Teknik | 45.3% |
| Univerzitar | 41.2% |

**19. Sa ka ndryshu jeta e serbëve të Kosovës që nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Brukselit?**



## 20. Cili është qëndrimi juaj për pjesëmarrjen e Serbëve në institucionet Kosovare?




Numri i të anketuarve të cilët përkrahin pjesëmarrjen e Serbëve në institucinet Kosovare dallon nga komuna në komunë:

| | përkrahin |
|---|---|
| Mitrovica veriore | 20% |
| Zubin Potoku | 15.2% |
| Leposaviqi | 20,3% |
| Zveçani | 31.1% |

## 21. A keni votuar në zgjedhjet parlamentare ne Kosovë më 2014?



Numri i votuesve në zgjedhjet e vitit 2014 dallon nga komuna në komunë:

| | votuan |
|---|---|
| Mitrovica veriore | 40.9% |
| Zubin Potoku | 45. % |
| Leposaviqi | 31.6% |
| Zveçani | 17.9% |

**22. A planifikoni të votoni në zgjedhjet e ardhshme?**




Një analyze e rezultatit vë në pah se gjeneratat e reja janë më pak të interesuara të marrin pjesë në proceset formale politike se sa të anketuarit e moshes më të vjetër, gjë që tregon se dallimi në moshë luan një rol të rëndësishëm kur bëhet fjalë për aktivitetet politike në kontekstin e Kosovës.

| | Unë do të dilja/ndoshta/ sigurisht |
|---|---|
| 18-29 | 25,4% |
| 30-45 | 35% |
| 45-65 | 35.9% |
| 66 + | 43.8% |

Numri më i madh i të anketuarve të cilët pohojnë se ndoshta do të/ sigurisht që do të votojnë janë nga Zubin Potoku (55.5%), pastaj Zveçani (35.8%), Mitrovica veriore (33.2%) dhe Leposaviqi (26.9%.)

### 23. A mendoni se do të themelohet Asociacioni I komunave serbe në Kosovë?



24. **Vlerëso prej 1 deri 5, me 1 - "asesi nuk pajtohem" dhe 5 - "plotësisht pajtohem", si do ti vlerësoni qëndrimet vijuese ndaj Asociacionit të komunave serbe:**

| | Rezultati mesatar |
|---|---|
| AKS do të kontribuojë në përmirësimin e gjendjes së Serbëve në Kosovë | 2.9 |
| AKS do të ndikojë në integrimin e Serbëve në kornizen politike dhe ligjore të Kosovës | 2.8 |
| AKS do te mundësojë ngritje ekonomike dhe punësim | 2.7 |




25. **Vlerëso prej 1 deri 5, me 1 "nuk do të ndodhë fare" dhe 5 -"tërësisht do të ndodhë", a do të ndihmojë Asocioacini iKomunave Serbe në jetën e serbëve të Kosovës:**

| | mesatarja |
|---|---|
| Serbët e Kosovës Veriore | 2.9 |
| Shqiptarët e Kosovës Veriore | 2.8 |
| Serbët në jug të lumit Ibër | 2.7 |
| Komunitet tjera Kosove | 2.7 |




**26. Në çka bazohet qëndrimi juj ndaj politikës dhe ngjarjeve politike në vend?**




Kur kemi të bëjë me preokupimet publike, burimi i informative është shumë i rëndësishëm në formimin e qëndrimit dhe opinionit.Është interesante se sitë anketuarit me shkallë të lartë të arsimimit emërojnë mediat si burim kryesor të informatave gjersa këta me shkallë më të ultë të arsimimit pohojnë se politikanët janë burimi i tyre kryesor i informimit.

**27. Vlerëso prej 1 deri 5, me 1 vlerëso "fare nuk u besoj" dhe 5 vlerëso "tërësisht besoj", sipas besimit tënd:**

| | mesatarja |
|---|---|
| Mediat serbe nga Beogradi | 3 |
| Mediat serbe nga Kosova | 2,7 |
| Mediat shqiptare | 1,5 |




**28. A jeni të lire që publikisht të shprehni pozitën tuaj politike?**



29. **A janeë qëndrimet e pavarruara dhe mendimi kritik të prezantuara në mënyrë adekuate në Kosovë?**




30. **A t'u është rreziku siguria jote personale apo e familjes sate në gjashtë mujorin e fundit?**



31. A ka ndryshu situate e sigurisë në Kosovën veriore gjatë vitit të fundit?




32. Sipas mendimit tuaj, cilat janë rreziqet më të mëdha të sigurisë në vendin tuaj?



**33. Si do të ndikojë hapja e urës së Ibrit në situatën e sigurisë?**




**34. Vlerëso prej 1deri 5, në çfarë mase ka avansuar Marrëveshja e Brukselilt të drejtat dhe liritë e Serbëve në Kosovë?**



**35. Vlerëso në cfarë mase respektohen liritë dhe të drejtat e serbëve në komunat serbe?**

| | |
|---|---|
| Të drejtat e gjuhës | 4 |
| Liria e besimit | 4 |
| E drejta për arsim | 3.9 |
| E drejta për kujdes shëndetësor dhe sigurim shëndetësor | 3.8 |
| E drejta e shprehjes së lire e përkatësisë kombëtare | 3.8 |
| E drejta e shprehjes së lirë | 3.5 |
| Liria e lëvizjes | 3.4 |
| E drejta për punë | 2.4 |

**36. A e shihni vetën në Kosovë në pesë vitet e ardhshme?**




Ashtu siç pritej, të anketuarit e rinj më tepër mendojnë ta lëshojnë Kosovën.Faktikisht46.5%  e të anketuarve mes moshes  18 dhe 29  pohojnë se nuk e shohin veten në Kosovë pesë vitet e ardhshme. Fakt i rëndësishëm është se ata të cilët pohonin se nuk e shohin veten në Kosvoë në pesë vitet e ardhsme ishin më të arsimuarit nga të gjithë të anketuarit. Kjo indikon se ky nuk është vetëm problem demografik por edhe teknokratik.

Një analizë e rezultatit se planet e ardhshme të anketuarve dallojnë nga komuna në komunë:

| | Unë nuk e shoh veten në Kosovë gjatë pesë viteve të ardhshme |
|---|---|
| Mitrovica Veriore | 37.5% |
| Zubin Potoku | 32.2% |
| Leposaviqi | 13.5% |
| Zvecanit | 10.3% |

**37. A e ka lëshu Kosovën dikush në afërsi tënde gjatë gjasht muajve të fundit?**



**38. A reagoni pozitivisht apo negativisht ndaj fjalës „ Bashkimi Evropian“?**




Përgjigjet në këto pyetje trgojnë se të anketuarit e rinj kanë qëddrim negative ndaj Bashkimit Evropian.Gati 10.9% e të anketuarve të ring kanë qëndrim pozitiv ndaj BE. Përkrahja për BE nuk është shumë më e lartë tek grupmoshat e vjetra,18.1% e të anketuarve mes moshës 30 dhe 45 kanë mendim pozitiv per BE, 16.3% e moshës 46-65 ,dhe 25% e të anketuarve mbi moshën 66 vj.

Përceptime të ndryshme lidhur me BE mund të hasim edhe tek të anketuarit me shkallë të ndryshme të anketuarve:

| | Asociacioni pozitiv |
|---|---|
| Fillor | 34.4% |
| I mesëm | 19.6% |
| I lartë/teknik | 10% |
| Universitar | 18.7% |

**39. Kur shpresoni që Kosova bëhet pjesëë BE?**




**40. Si e shihni pozitën e BE ne negociata mes Beogradit dhe Prishtinës?**




Dallim i madh shihet në përgjigjet e këtyre pyetjeve në bazë të shkallës se arsimimit. Të anketuarit me arsim fillor 21.5% të rasteve, pohojnë se ata shohin që BE përkrahë Prishtinën në negociaa gjeersa numri është shumë më I madh në mesin me arsim univerzitar 88.8%.

41. **Si do të ndikojë në personalitetin tuaj pranimi I Kosovës në BE?**




42. **Si do të ndikohnte pranimi I Kosovës ne BE ne situatën e tanishme socio - ekonomike në Kosovë?**



**43. A e përkrahni pranimin e Kosovës në Bashkimin Evropian?**




Shkalla e arsimimit luan një rol të rëndësishëm në këtë gjithashtu:

| | Nuk përkrahu | Plotësisht përkrahu |
|---|---|---|
| Fillor | 25% | 18.8% |
| I mesëm | 58.7% | 0.2% |
| I lartë/teknik | 62.4% | 1.4% |
| Universitar | 57.4% | 2.1% |

Përgjigjet dallohen edhe në bazë të komunave:

| | përkrahu |
|---|---|
| Mitrovica veriore | 19.9% |
| Zubin Potoku | 4.2% |
| Leposaviqi | 12.8% |
| Zvecani | 14.9% |

**44. Vlerëso prej 1 deri 5, ku 1 - "assesi nuk pajtohem" dhe 5 dotë thotë "plotësisht pajtohem", vleerëso realitetin e pohimeve vijuese:**

| | Mesatarja |
|---|---|
| BE luan rol kyq në zgjidhjen e problemeve të komunitetit Serb në Kosovë. | 2.7 |
| BE luan rol kyq në pajtimin ndër etnik në Kosovë. | 2.5 |
| BE investon mjaft në Kosovën veriore. | 2.2 |
| Nëse Kosova do të pranohet ne BE serbët do të ishin më të mbrojtur | 2 |



## 45. Matja e distancës etnike

Pranimi i anëtarit të komunitetit Shqiptar:




**Shkalla e distancës etnike** *(totale)*




Edhepse në disa shoqëri shkalla e matjes së dallimit etnik ndryshon varësisht nga mosha , në rastin tonë ne nuk ishim në gjendje të shohim një

ndryshim të madh statistik në kuptimin e plotë të fjalës mes të anketuarve të rinj dhe atyre të vjetër. Megjithatë, shkalla e arsimimit luan një rol të madh në shpërndarjen e përgjigjeve në nivel të distancës etnike:

| | Distanca etnike e mesme dhe e madhe |
|---|---|
| Fillor | 96.9% |
| I mesëm | 74.7% |
| Teknik | 87.2% |
| I lartë | 74.9% |

Një ndër faktorët më të rëndësishëm që ndikon në reduktimin e distancës etnike mes serbëve dhe shqiptarëve në kontekstin e kalimit të kohës së serbëve në vendet ku shqiptarët janë shumicë.Kryesisht testet e korelacionit demonstrojnë një korelacion të mesëm negativ (r = -0.39) që tregon se sa më shumë kohë kanë kaluar të anketuarit në hapësirat ku jetojnë shqiptarët aq më e shkurtë është distancë etnike.

# Përfundim

- Hulumtimi tregon se banorët e Kosovës veriore janë shumë të pakënaqur me situatën aktuale politike, ekonomke and ate të sigurisë. Është brengosës fakti se banorët jo vetëm që vlerësojnë kushtet si të varfëra por edhetrendin ezhvillimit në Kosovë e konsiderojnë si negativ. Fakti që çdo i tretil anketuar beson se jeta për serbët në Kosovë do të përkeqësohet në tri vitet e ardhshme shërben të konfirmojnë të dhënat e lartpërmendura.

- Përgjigjet tregojnë se ekziston shkallë e lartë e mosbesimit në institucionet politike dhe procedurat në Kosovë.  Duke pasë parasysh këtë, nuk është për tu befasuar se një numër i madh i të anketuarve nuk dëshirojnë të shfrytëzojnë të drejtën e vet të votimit.  Fakti se shumica e të anketuarve nuk u besojnë politikanëve Serb dhe shqiptar ndikon drejtpërdrejti në këtë pasivitet politik.Në këtë rast, zgjedhjet janë garë mes më të voglit nga dytë këqinjve dhe jo zgjedhja e më të mirit ose kandidatit më të kualifikuar.

- Përpos që të anketuarit janë pasiv ata gjithashtu shprehin mungesën e vetbesimit duke zgjidhë përgjigjen 'nuk kam ide" ose " nuk e di". Lidhur me këtë, është interesant fakti se 40% e të anketuarve nuk janë shprehë lidhur me Marrëveshjen e Brukselit, një pakt që disktohet shpesh dhe i cili duhet të implementohet dhe që mund të ndikojë pozitivisht në realitetin socio – politik në Kosovë.

- Sai përket aspektit të popullsisë ka gjasë të bëhet problematiknga se, bazuar në hulumtim, një numër i konsiderueshëm i të anketuarve mendojnë të lëshojnë Kosovën gjatë pesë viteve të ardhshme. Ky problem është akut nga se parashihet të përfshijë gjeneratën e re dhe të arsimuar e cila me largimin e vet mund të rrisë problemet demografike dhe teknokratike në favor të një popullate të moshuar dhe të pa arsimuar në Kosovë.

- Të anketuarit në Kosovën veriore nuk e shohin rolin e Bashkimit Evropian në process të zgjidhjes së statusit të Kosovës në mënyrë pozitive. Ky trend Euroskeptikvie  në prononcimet e të rinjëve dhe të arsimuarve të cilët nuk besojnë se Bashkimi Evropian ka standarde të njejta për dy plaët në procesin e negociatave. Duke pasë parasysh këtë, nuk është për tu befasuar se vetëm një numër i vogël i të anketuarve përkrahin anëtarësimin e Kosovës në BE.

- Distanca etnike mes serbëve dhe shqiptarëve është e madhe dhe gjëja e vetme që mund të zvogëlojë këtë distancë është frekuenca dhe intensifikimi i kontakteve personale.Sa më shumë njerëz të takohen, komunikojnë, bashkëpunojnë dhe ndajnë hapësirat e banimit aq më e madhë është tendenca për shkurtimin e distances mes anëtarëve të këtyre dy grupeve në distance.

Hulumtimi  është pregaditur për projektin e “Point One”.Hulumtimin e realizoi OJQ “AKTIV” Brenda kornizës së projektit të “Point One” të implementuar nga Qendra e Energjisë Qytetare.Projekti është financuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të hapur.

Shënim: Projekti është përkrahë nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të hapur. Pikëpamjet ose konkluzionet e shprehura në këtë publikim nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit Kosovar për Shoqëri të hapur.

CIVIC ENERGY CENTER

AKTIV

KFOS
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society




AKTIV

CIVIC ENERGY CENTER

KFOS

Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society